

Versionet hetimore lidhur me procedimin penal 03/2020.

1.Subjekti Frederik Ymeri gjatë kohës që ka shërbyer në SHISH, ku detyrën e fundit ka mbajtur atë të Drejtorit të Krimit Organizuar në Drejtorinë Qëndrore të SHISH, mund të ketë krijuar dhe mbajtur lidhje (kontakte) me punonjës të ndonjë shërbimi apo policie të ndonjë shteti tjetër të cilëve u jep informacione të natyrës së krimit të organizuar kundrejt pagesës. Dyshohet se informacionet që subjekti jep, kryesisht bëjnë fjalë lidhur me shtetas Shqiptarë apo Kosovarë të cilët ushtrojnë aktivitete kriminale si trafikim narkotikësh, etj në shtete të ndryshme të Europës.

2.Subjekti Frederik Ymeri ka shfaqur interes gjithashtu për të grumbulluar edhe informacione të natyrës politike, të cilat ia kërkon lidhjes së tij Luftar Çunaj, banues në Vlorë. Konkretisht kanë rezultuar këto interesime të tij :

Më datë 07.01.2021, subjekti Frederik Ymeri përdorues i numrit 0672039151, i dërgon mesazh Luftarit përdorues i numrit 0698760233 me tekst : ***“Nëse ke mundësi të sqarosh kush janë lidhjet shoqërore të Koço Kokëdhimës ? Nga financohet partia e tij dhe ç’farë marrëdhëniesh ka me partitë PD dhe LSI ? Shkruaj sa më gjatë. Na duhen para datës 10”.***

- Luftari i kthen përgjigje me mesazh me tekst : ***“Do bëj disa takime dhe të vij në Tiranë të pimë kafe. Do të njoftoj 1-ditë para se të vij”.***

Më datë 12.03.2021, ora 17:19:00, subjekti Frederik Ymeri përdorues i numrit 0672039151, i dërgon mesazh Luftarit përdorues i numrit 0698760233 me tekst : ***“Luftar gezohem te jeni mire familjarisht. Jam ne merak per shendetin tuaj familjar. A jeni mire. Brenda mundesive eshte e nevojshme te kemi informacion per prezencen e Agimit te Arte ne Shqiperi. Te fala”.***

- Ora 17:22:17 Luftari i kthen përgjigje me mesazh subjektit Frederik Ymeri me tekst: ***“Ok, do vij”.***
- Ora 17:23:29, subjekti Frederik Ymeri i dërgon sërish mesazh Luftarit me tekst: ***“Faleminderit po mos u nxito qe te kemi nje panorame te plote”.***
- Ora 17:26:04, Luftari i dërgon sërish mesazh subjektit Frederik Ymeri me tekst: ***“Pa merak, rendesi te jemi te sakte”.***

Më datë 29.03.2021, ora 09:04:51, subjekti Frederik Ymeri përdorues i numrit 0672039151 i dërgon mesazh Luftar Çunaj përdorues i numrit 0698760233 me tekst : ***“Luftar mire jeni familjarisht.Mua te merkuren afati i porosise. E di qe jeni i zene shume me pune. Nese mundesh mundet te me dergosh nje mesazh me emrat. Falem”.***

- Ora 09:22:59, Luftari i kthen përgjigje me mesazh subjektit Frederik Ymeri me tekst: ***“Neser heret do jem ne kafe te pime bashke, i kam pergatitur ti sjell.Respekt”.***

Dyshohet se këto informacione ai mund t’ja serviri ndonjë subjekti politik por që nga puna hetimore e bërë deri aktualisht nuk është mund të zbardhet se ku konkretisht i dërgon këto informacione.

Veprime hetimore në funksion të hetimit të cilat sugjerojmë të kryhen në vijim :

1.Të bëhet një kombinacion ku të shoqërohet subjekti Maksim Ferra para takimit me subjektin Frederik Ymeri me qëllim për të kopjuar dhe marrë të dhëna lidhur me permbajtjen e USB-së që ai i jep subjektit Frederik Ymeri gjatë takimeve. Kombinacioni të bëhet me pretekstin se shtetasi Maksim Ferra duhet të pyetet lidhur me disa transferta të marra prej tij nga shtetas të ndryshëm nëpërmjet Western Union. ***(Nëpërmjet këtij veprimi do të zbardhet natyra e informacionit që ai i jep subjektit Frderik Ymeri).***

2.Të ushtrohet kontroll fillimisht në banesën e subjektit Maksim Ferra ku të sekuestrohen paisjet e ndryshme elektronike të cilat ai posedon si Kompjutera, Laptop, Aparate telefoni celular, etj për të parë çfarë informacionesh ky subjekt ka përpunuar në këto pasije dhe nëpërmjet USB-ve ja ka përcjell subjektit Frederik Ymeri. ***(Edhe nëpërmjet këtij veprimi do të zbardhet natyra e informacionit që ai i jep përpunon dhe i jep me USB subjektit Frderik Ymeri).***